



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI QARKUT DIBER

**SHPALLJE PËR LEVIZJE PARALELE
NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË E MESME DHE TË ULËT DREJTUESE**

- **Përgjegjës Sektori Çështjeve Ligjore në Këshillin e Qarkut Diber**

Në zbatim të nenit 26 të ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), si dhe të Kreut II, III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, (i ndryshuar) të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Qarkut Diber shpall procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranim në shërbimin civil për pozicionin:

- **Përgjegjës Sektori Çështjeve Ligjore në Këshillin e Qarkut Diber**
Klasa e pagës III-2

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil.

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE

15.09.2026

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

21.09.2026

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Përgatitja e dokumentave ligjore, përfshirë kontratat, marrëveshjet, dhe dokumentacionin tjetër ligjor sipas nevojave.
2. Ofrimi i këshillave juridike për menaxhimin e çështjeve ligjore që lidhen me veprimtarinë e Këshillit të Qarkut.
3. Përfaqësimi i Këshillit të Qarkut Dibër në çështjet gjyqësore në të dyja shkallët e gjykimit, për fshirë hartimin e kërkesë-padive dhe ankimeve.
4. Përgjigjet për zbatimin e rregullave të menaxhimit të burimeve njerëzore konform legjislacionit.
5. Organizon dhe realizon procesin e pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në përputhje me Ligjin Nr.152/2013"Për Nëpunësin Civil". Krijon dhe administron dosjen e konkurimit.
6. Kujdeset për respektimin e etikës, disiplinës (orarit të punës), rregullit dhe pastërtisë në institucion.
7. Përgatit projektvendimin për strukturën e administratës dhe nivelin e pagave në bashkëpunim me Shefin e Sektorit të Financës.
8. Harton vendimin për planifikimin e pranimeve vjetore në Shërbimin Civil dhe i bën ato publike.
9. Krijon, administron, plotëson dhe sistemon dosjet personale të çdo të punësuar me dokumente origjinale ose fotokopje të noterizuara.
10. Krijon dhe administron regjistrin themeltar të punonjësve me të dhënat profesionale dhe të marrëdhënieve të punës.
11. Është anëtare e Komitetit të Përhershëm të Pranimit, Komisionit të lëvizjes paralele dhe Komisionit të Ngritjes në Detyrë.
12. Harton vendimet për emërimet dhe përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil konform Ligjit Nr. 152/2013.
13. Harton urdhëra individuale dhe kontrata pune për punonjësit që trajtohen sipas Kodit të Punës.
14. Monitoron dhe merr pjesë në procesin e hartimit të përshkrimeve të punës.
15. Harton Planin Vjetor dhe Planet Mujore të sektorit.
16. Kryen vlerësimet periodike të nëpunësve të sektorit.
17. Përgjigja ndaj kërkesave të informacionit dhe dokumentacionit nga autoriteti ligjor dhe organet përgjegjëse.
18. Realizon bashkërendime e bashkëpunime të vazhdueshme me kabinetin dhe specialistët e sektorëve të tjerë brenda institucionit për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë veprimtarisë.
19. Përgatit materiale,informacione të ndryshme,sipas planifikimit dhe kërkesave për Kryetarin,Kryesinë dhe Këshillin e Qarkut.
20. Mban kontakte të vazhdueshme me organizma të tjerë homologe,me të cilat ka mardhënje Këshilli I Qarkut si dhe organizma të ndryshme nderkombëtare.
21. Harton dokumentacionin e nevojshëm për dosjet e pensioneve të vecanta dhe për statusin e dëshmorit duke mbajtur lidhje me komisionet përkatëse të ngritura nga Këshilli i Qarkut.
22. Raporton në mënyrë periodike tek titullari i institucionit për ecurin e punëve.

LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedure vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori III;
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" apo "Master Profesional" të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Shkenca Juridike Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.
- c- Të kenë njohuri të specialiteteve brenda fushës së kërkuar profesionale. Aftësi për të ofruar drejtim teknik për të koordinuar, zhvilluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve, aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrimi plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-standard>.
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor) Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehësimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dorëzimi i dokumentave për lëvizjen paralele duhet të bëhet me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion (Këshilli i Qarkut Dibër) brenda datës 15.09.2026 ora 12.00

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **17.09.2026** Njësia Përgjegjëse në Këshillin e Qarkut Diber do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të lëvizjes paralele si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të procedurës së lëvizjes paralele do të njoftohen individualisht nga Sektori i Çështjeve Ligjore në Këshillin e Qarkut Diber në mënyrë elektronike, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- b- Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; i ndryshuar
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr.119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”;
- d- Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; i ndryshuar
- e- Njohuritë mbi ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" i ndryshuar
- f- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”; i ndryshuar
- e- Njohuritë mbi ligjin nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.
- g- Njohuritë mbi ligjin Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike [ëëë.dap.gov.al](http://ee.dap.gov.al).

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Sektori Juridik në Këshillin e Qarkut Diber do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të internetit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Sektori Juridik për rezultatet (nëpërmjetadresës së e-mail).

NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil. Këtë informacion do ta merrni në “Portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Qarkut Diber duke filluar nga **data 17.09.2026**

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brenda kategorisë IV;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “**Mirë**” ose “**Shumë mirë**”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" apo "Master Profesional" të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Shkenca Ekonomike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion;
- c- Të kenë njohuri të specialiteteve brenda fushës së kërkuar profesionale. Aftësi për të ofruar drejtim teknik për të koordinuar, zhvilluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve, aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si mëposhtë:

- a- Jetëshkrimi plotësuar nëpërputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-standard>.
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor) Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehësimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dorëzimi i dokumentave për ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil duhet të bëhet me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion (– Këshilli i Qarkut Diber, Bulevardi) “Elez Isufi”, Peshkopi, brenda datës **21.09.2026 ora 12.00**

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Duke filluar nga **data 23.09.2026**, **Spektori i** Çështjeve Ligjore në Këshillin e Qarkut Diber do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën date kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga **Spektori i** Çështjeve Ligjore i Këshillit të Qarkut Diber, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- b- Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; i ndryshuar
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr.119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”;
- d- Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; i ndryshuar
- e- Njohuritë mbi ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" i ndryshuar
- f- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”; i ndryshuar
- e- Njohuritë mbi ligjin nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.
- g- Njohuritë mbi ligjin Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- d- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në **40 pikë**;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **20 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurave të lëvizjeve paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike ëëë.dap.gov.al.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njesia Pergjegjese (**Sektori i** Çështjeve Ligjore) në Këshillin e Qarkut Diber do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të internetit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njesia Pergjegjese **Sektori i** Çështjeve Ligjore) për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil do të marrin informacion në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Qarkut Diber për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- Për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Qarkut Diber duke filluar nga **data 23.09.2026**